

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6429  
E shtunë, 2 tetor 2021  
çmimi 0.40 €

FSK-së i shtohen edhe  
20 kadetë të rinj FAQE 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PARTITË OPOZITARE KANË KRITIKUAR QEVERINË E KOSOVËS PËR REFUZIMIN  
E PROJEKTIT PËR INFRASTRUKTURËN E GAZIT FAQE 4-5

## REFUZIMI I PROJEKTIT TË GAZIT, HAP I GABUAR STRATEGJIK



Subjektet politike opozitare e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për refuzimin e projektit për ndërtimin e infrastrukturës së gazit në Kosovë të financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e Qeverisë së

ShBA-së (MCC). Sipas tyre, ky veprim i qeverisë është hap i gabuar strategjik. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë vlerësuar se ky vendim është kundër interesave të Kosovës dhe shqiptarëve në rajon

## VITIA JEP DORËHEQJE NGA POSTI I MINISTRIT, ANGAZHOHET NË GARËN PËR PRISHTINËN FAQE 3



## 24-VJETORI I PROTESTËS STUDENTORE I '97-S NUK I BËRI BASHKË ISH-LIDERËT STUDENTORË FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## FILLON SUBVENCIONIMI I KREDIVE KONSUMUESE F. 8

## KOSOVA DHE SLLOVENIA, MUNDËSI TË REJA BASHKËPUNIMI NË BUJQËSI F. 8

## SPORT



## CHALLANDESI DHE NEESI PUBLIKOJNË LISTAT E FUTBOLLISTËVE F. 12

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# NATO-ja: KFOR-i do të sigurojë zbatimin efektiv të marrëveshjes në veri



PRISHTINË, 1 TETOR - NATO-ja ka mirëpritur marrëveshjen midis Kosovës dhe Serbisë për shtensionimin e situatës në veri. Në një deklaratë për media, zëdhënësja Oana Lungescu ka theksuar se misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, "do të luajë një rol themelor për të siguruar zbatimin efektiv" të marrëveshjes. Që nga 20 shtatori serbët në veri të Kosovës kanë bllokuar vendkalimet kufitare me Serbinë: Jarinjë dhe Bërnjak. Kjo ka ndodhur pasi Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që

shoferët e makinave me targa të Serbisë t'i zëvendësojnë ato me targa të përkohshme derisa vozitin në Kosovë. Masa të ngjashme për makinat me targa të Kosovës, Serbia ka zbatuar tash e sa vite. Për ta mbikëqyrur procesin, Kosova ka dërguar në veri edhe njësitë speciale policore. Me marrëveshjen e arritur të enjten në Bruksel serbët do t'i heqin bllokadat, njësitë speciale të policisë do të tërhiqen nga Jarinja dhe Bërnjaku dhe atje do të vendoset KFOR-i, ndërsa në targa të të dyja palëve do të

vendosen përkohësisht letra ngjitëse. Marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë u ndërmjetësua nga Bashkimi Evropian. "NATO-ja vazhdon ta mbështetë fuqishëm dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës. Kjo është rruga e vetme drejt arritjes së një marrëveshjeje të qëndrueshme politike për rajonin dhe është kyçe për stabilitetin e të gjithë rajonit", ka thënë Lungescu.

## 78 për qind e të infektuarve në Maqedoninë e Veriut, të pavaksinuar

SHKUP, 1 TETOR - Ministria e Shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut ka publikuar një analizë mbi gjendjen e të infektuarve me koronavirus, me çka ka konstatuar se 78 për qind e rasteve janë persona të pavaksinuar. Analiza i referohet periudhës prej 6 gushtit deri më 30 shtator.

Gjatë kësaj periudhe me koronavirus janë infektuar 35 531 persona dhe prej tyre 23 për qind apo 8 233 persona kanë marrë nga dy doza të vaksinave. Sipas të dhënave, 27 298 persona, apo 77 për qind e atyre që kanë rezultuar

pozitivë nuk ishin të vaksinuar. Edhe nga të shtruarit në spitale, 79 për qind ishin të pavaksinuar, ndërsa 21 për qind e të gjithë atyre që u pranuan në spital gjatë kësaj periudhe ishin plotësisht të vaksinuar. Sa i përket vdekshmërisë, në periudhën nga 6 gusht deri më 30 shtator në Maqedoninë e Veriut vdiqën 1 162 persona me këtë virus. Prej këtyre, 987 pacientë nuk ishin të vaksinuar dhe 15 për qind, apo 175 persona ishin të vaksinuar me nga dy doza. Ministria e Shëndetësisë bëri me dije se të vaksinuarit që vdiqën kishin disa

sëmundje kronike.

Krahasuar me analizën e publikuar javën e kaluar, numri i të infektuarve, të shtruarve dhe të vdekurve të vaksinuar është rritur për 1 për qind. Numri i rasteve aktive me Covid-19 është rreth 12 mijë.

Institucionet shëndetësore i bëjnë thirrje popullatës që të vaksinohet si mënyrë e vetme për mbrojtje nga sëmundja Covid-19 që shkakton koronavirusi.

Në Maqedoninë e Veriut deri më tani është vaksinuar rreth 35 për qind e popullatës.



## Shtyhen bisedimet BE - Australi për shkak të paktit Aukus

Bruksel, 1 tetor - Bisedimet tregtare midis Australisë dhe Bashkimit Evropian u shtynë për shkak të një grindjeje me Francën mbi të ashtuquajturin pakt i sigurisë Aukus. Muajin e kaluar Kanbera anuloi një marrëveshje prej 37 miliardë dollarësh me Parisin për të ndërtuar një flotë nëndetësesh konvencionale. Në vend të saj, ajo do të ndërtojë së paku tetë nëndetëse me energji bërthamore, me teknologji të



ShBA-së dhe Britanisë. Vendimi e zemëroi Parisin, i cili e cilësoi paktin midis Australisë,

ShBA-së dhe Britanisë si "goditje në shpinë". Në solidaritet me Francën,

presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, vuri në dyshim arritjen e një marrëveshjeje tregtare midis BE-së dhe Australisë.

Rundi i 12-të i bisedimeve BE - Australi, i paraparë të mbahet në tetor, u shty për në nëntor. Në qershor, pas raundit të fundit të bisedimeve për një marrëveshje të tregtisë së lirë, Komisioni Evropian ka njoftuar se negociatat "kanë shënuar përparim në shumicën e

fushave".

Raundi i ardhshëm i bisedimeve pritet të trajtojë një numër çështjesh, përfshirë: tregtinë, investimet dhe të drejtat e pronësisë intelektuale, por rezultatet nga ky takim mbeten të paqarta.

BE-ja është partneri i tretë më i madh tregtar i Australisë; tregtia e mallrave dhe shërbimeve midis tyre arriti në pothuajse 72 miliardë dollarë vitin e kaluar.

## Koreja e Veriut teston edhe një raketë

SUEL, 1 TETOR - Koreja e Veriut tha se ka testuar një raketë antiajër "të zhvilluar rishtazi". Sipas agjencisë verikoreane të lajmeve "Kcna", prova u krye të enjten. "Kecna: ka njoftuar se raketa ka një "performancë të jashtëzakonshme luftarake"

dhe përfshin teknologji të reja. Ditë më parë Koreja e Veriut ka njoftuar se ka testuar edhe një raketë të re hipersonike e cila besohet se ka aftësi bërthamore. Muajin e kaluar ajo ka testuar edhe raketa lundrimi me rreze të gjatë veprimi dhe raketa

balistike. Sekretari amerikan i Shtetit, Anthony Blinken, ka thënë se testet e tilla "krijojnë shanse më të mëdha për paqëndrueshmëri dhe pasiguri". Phenjani thotë se armët e tij janë të nevojshme për

vetëmbrojtje dhe e akuzon ShBA-në dhe Korenë e Jugut për "standarde të dyfishta". Shteti komunist tash e sa vite është nën sanksione ndërkombëtare për armët e tij bërthamore dhe programet e raketave balistike.



# Vitia jep dorëheqje nga posti i ministrit, angazhohet në garën për Prishtinën

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka dhënë dorëheqje nga pozita e ministrit. Tash ai do të përqendrohet në garën për kryetar të Prishtinës. Këtë vendim ai ka thënë se e ka marrë në bashkërendim me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe partinë e tij, Lëvizjen Vetëvendosje. "Unë sot po e përmbyll angazhimin tim në këtë detyrë me të cilën më pati ngarkuar kryeministri Kurti, ndaj të cilit do të jem mirënjohës jo vetëm për besimin, por edhe për përkrahjen e rezervë", ka thënë Vitia në një konferencë për media mbajtur të premten teksa ka shtuar se ka qenë privilegj udhëheqja e Ministrisë së Shëndetësisë në kohën kur Kosova është përballur me pandeminë Covid-19. "Unë nga tani e tutje do të jem pjesë e një ekipi tjetër, që ka në fokus kryeqytetin tonë", ka thënë ai.

Ministria e Shëndetësisë, sipas Vitisë, tani do të udhëhiqet nga zëvendësmministria Dafina Gexha. Gjatë konferencës për media Vitia, i cili ka shërbyer ministër i Shëndetësisë në dy qeveri të udhëhequr nga Albin Kurti, ka folur për situatën me pandeminë Covid-19. Ai ka thënë se me ritmin aktual të vaksinimit, koronavirusi do të vihet nën kontroll. "Sot jam i

lumtur që para jush mund të them se vala e katërt e pandemisë, e dominuar nga varianti 'Delta', edhe sipas parametrave të OBSH-së, për momentin është vënë nën kontroll", ka thënë Vitia. Ai ka treguar se, sipas parashikimeve të Qeverisë së Kosovës, deri në fund të vitit mbi 75 për qind e popullatës mbi 16 vjeç do të imunizohet kundër koronavirusit. Zgjedhjet e rregullta lokale do të mbahen më 17 tetor.

Fushata për zgjedhjet lokale ka nisur më 16 shtator dhe do të zgjasë 30 ditë.

Në garë për kreun e Prishtinës janë edhe Uran Ismaili nga Partia Demokratike e Kosovës, Përparim Rama nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Daut Haradinaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Gëzim Mehmeti nga Aleanca Kosova e Re.



## Zemaj për dorëheqjen e Arben Vitisë: Dështimit nuk mund t'i ikë

Ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Mehaj, ka reaguar pas dorëheqjes së Arben Vitisë nga pozita e ministrit të Shëndetësisë. Ai ka thënë se sot iku nga detyra ministri më i dështuar i qeverisë më populliste. "Thënë ndryshe, e lëshoi detyrën për të synuar një detyrë të re, duke

lënë të nënkuptohet se ishte bërë ministër me qëllim që nesër të synojë të bëhet kryetar komune. Në të vërtetë, fillimisht ai duhej të shkarkohej apo të jepte dorëheqje të paravokueshme si rezultat i mungesës së menaxhimit të pandemisë, ku për pasojë i theu të gjitha rekordet e zeza në

botë për vdekshmëri dhe numër të të infektuarve me Covid-19. Pra, papërgjegjësinë e dëshmoi. Paaftësinë e vulosi. Rekordet e zeza që vetë i arriti, po dhe vetë i theu. Dështimit nuk mund t'i ikë", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## PSD-ja: Marrëveshja për targat, katalizator për Asociacionin



PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur të premten një aktivitet pranë Qeverisë së Kosovës për marrëveshjen trepikëshe të arritur në Bruksel me Serbinë për targat e automjeteve. Aktivistët e PSD-së kanë vendosur letër ngjitëse në veturat

zyrtare të Qeverisë së Kosovës. "Marrëveshja që u nënshkrua dje, e ka edhe mbrapa edhe përpara Asociacionin. Është edhe në logjikën e Asociacionit. Trajtimi i ndarë mbi targat ka parasysh kritere etnike dhe territoriale, kritere të Asociacionit. Targat e tilla janë ilegale, thotë qeveria, por

në të njëjtën kohë i njohim me marrëveshje. Do të mund të flitej për reciprocitet të plotë në targa sikur Kosova të prodhonte targa për shqiptarët e Luginës dhe këtë ta pranonte Serbia. Por jo, është vetëm veriu i vendit që po trajtohet në mënyrë të diferencuar", është thënë në

mesazhin e PSD-së. Sipas kësaj partie, marrëveshja për targat është kthim mbrapa në dialogun teknik. "Kosova po dialogon për targa e letërngjitëse dhe jo për marrëveshje finale. Mbi të gjitha, kjo marrëveshje është katalizator për formimin e Asociacionit. Një gjë të tillë

tashmë e bëri të qartë shprehimisht zyra e shërbimit të jashtëm e BE-së pas nënshkrimit të marrëveshjes sepse qeveria po këmbëngulë për zbatimin e një marrëveshjeje të Brukselit, tash marrëveshjet e tjera presin. Asociacioni ndër të parat", është thënë në deklaratën e PSD-së.



PARTITË OPOZITARE KANË KRITIKUAR QEVERINË E KOSOVËS PËR REFUZIMIN E PROJEKTIT PËR INFRASTRUKTURËN E GAZIT

# Refuzimi i projektit të gazit, hap i gabuar strategjik

Subjektet politike opozitare e kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për refuzimin e projektit për ndërtimin e infrastrukturës së gazit në Kosovë, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e Qeverisë së ShBA-së (MCC). Sipas tyre, ky veprim i qeverisë është hap i gabuar strategjik. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë vlerësuar se ky vendim është kundër interesave të Kosovës dhe shqiptarëve në rajon

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Vendimi i Qeverisë së Kosovës për të mos e çuar përpara projektin për ndërtimin e infrastrukturës së gazit në Kosovë, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e Qeverisë së ShBA-së (MCC), ka nxitur kritika të shumta nga opozita. Subjektet politike opozitare kanë bërë me dije se ky veprim dëmton partneritetin strategjik të Kosovës me ShBA-në.

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se ky është vendimi më anti-shqiptar që ka marrë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. “Me jo-në për gazsjellësin amerikan, ky njeri

ka nisur epokën anti-Kosovë dhe anti-Amerikë, por ju siguroj se nuk do të ketë sukses. Kam një pyetje edhe për presidenten e vendit. Pse po hesht për refuzimin shtetëror të projektit amerikan të gazsjellësit? Kjo heshtje e bën këtë goditje edhe më të dhimbshme dhe frikësuese. Jo më shumë se dy javë më parë, ajo pat thënë: ‘Kosova s’ka refuzim. Kosova s’mund të ketë rrugëdalje tjetër përpos bashkëpunimit me ShBA-në’. E çfarë ndodhi tash. Sqarohuni para popullit kah jeni nisur”, ka thënë lideri i AAK-së. Sipas tij, kryeministri duhet të japë dorëheqje. “Albin Kurti me dy veprimet e fundit e ka rrezikuar shtetin dhe partneritetin me ShBA-në. Ai i ka plotësuar të

gjitha kushtet për dorëheqje. Mbetja e tij në detyrë vetëm edhe për një ditë është e dëmshme për Kosovën”, ka deklaruar Haradinaj. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka vlerësuar të dëmshëm vendimin e qeverisë për refuzimin e këtij projekti. “Qeveria e Kosovës refuzoi projektin më gjeostrategjik amerikan në Ballkan, atë të gazpërçuesit, që do t’i siguronte shtetit tonë furnizim me gaz e, së këndejmi, edhe tranzicionin e nevojshëm energjetik. Përveçse në paranoizmin e pashpjegueshëm politik, e cilësoi të njëjtin si ‘gaz rus’, me këtë vendim Kosova i refuzoi dhe 200 milionë dollarë, që presidenti Biden kohë më parë

i kishte konfirmuar si grant - fonde falas - për Republikën e Kosovës dhe projektin në fjalë”, është thënë në komunikatën për media të LDK-së. Sipas LDK-së, ecja strategjike e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë e përbashkët në çdo fushë. “Një hap i gabuar strategjik. Një veprim i pakuptueshëm për interesat shqiptare në rajon. Një humbje financiare dyqind milionëshe në një vend pa zhvillim. E pakuptimtë, e dëmshme, e papranueshme. Përkushtimi i Kosovës në projekte strategjike amerikane nuk duhet të ketë hezitim. Ecja jonë strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të jetë e përbashkët në politikë, ekonomi, siguri dhe energjetikë”, ka vlerësuar LDK-ja. Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook”, ka shkruar se nuk është befasues vendimi anti-amerikan i qeverisë aktuale për

gazsjellësin. “Anti-amerikanizmi i LV-së dhe liderit të saj është manifestuar vazhdimisht. Ky është një zhvillim i rrezikshëm për interesat gjeostrategjike të Kosovës të cilat duhet të jenë në linjë me Perëndimin dhe pro-amerikane. Pyetja është se për kë punojnë LV-ja dhe qeveria Kurti?”, ka shkruar Tahiri. Ditë më parë edhe PDK-ja kishte kërkuar aprovimin e menjëhershëm të projektit amerikan për infrastrukturën e gazit dhe termocentralin me gaz. Sipas PDK-së, lidhja e Republikës së Kosovës në infrastrukturën e gazit që gëzon përkrahjen e plotë të ShBA-së është interes strategjik, ekonomik dhe gjeopolitik. “Në kohën kur ekonomia e Kosovës ka përjetuar goditje dhe është duke u përballur me pasojat e pandemisë, si dhe po vuan mungesën e një plani të mirëfilltë e të qëndrueshëm për rimëkëmbje ekonomike, investimi i 200 milionë



i mbledhin nënshkrimet e deputetëve për të thirrur seancë të jashtëzakonshme, ku do të diskutohej për refuzimin e projektit të gazsjellësit amerikan nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe nënshkrimin të marrëveshjes për targa, ku faktikisht përmes asaj marrëveshjeje qeveria Kurti ka pranuar që në veriun e Kosovës të ushtrojë sovranitetin edhe Qeveria e Serbisë! Sot më shumë se kurrë Kosovës i duhet një opozitë parlamentare aktive, e cila përmes mekanizmit të Kuvendit do t'i kërkonte përgjegjësi kësaj qeverie për dëmet që po ia shkakton vendit”, ka deklaruar Limaj.

Të enjten ministria e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, ka njoftuar të enjten se Kosova nuk do ta çojë përpara projektin për ndërtimin e infrastrukturës të gazit në Kosovë, i financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit e Qeverisë së ShBA-së (MCC).

Në një konferencë për media, Rizvanolli ka thënë se vendimi është marrë pasi Kosova ka nevojë për më shumë informata, për të qenë e sigurt se ndërtimi i infrastrukturës së gazit është opsioni më i mirë për tranzicionin energjetik. Ajo ka thënë MCC-ja ka afate kohore strikte për zhvillim dhe nënshkrim të programit të kompaktit. “Përballë afateve kohore të MCC-së ne kemi vendosur të ecim tutje dhe ta shfrytëzojmë investimin e alokuar për programin e kompaktit, për investime me risk më të ulët por që, gjithashtu, e ndihmojnë Kosovën drejt dekarbonizimit të sektorit të energjisë dhe krijojnë kushte për zhvillim ekonomik dhe zhvillim të sektorit privat”, ka deklaruar Rizvanolli.

dollarëve si grant i pakthyeshem në ekonominë e Kosovës, sidomos në sektorin e energjisë, jo vetëm që është i nevojshëm, por përfaqëson edhe interes madhor shtetëror”, është thënë në komunikatën e PDK-së.

Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kërkuar nga opozita të thërrasë seancë të jashtëzakonshme parlamentare për të diskutuar për refuzimin e projektit të gazsjellësit amerikan nga ana e qeverisë. “Si ka mundësi që partitë parlamentare opozitare të mos

# Burg të përjetshëm burrit që vrau gruan



**PRIZREN, 1 TETOR** - Gjykata Themelore në Prizren ka dënuar me burgim të përjetshëm B. V., i akuzuar për vrasjen e bashkëshortes me inicialet A. A. Vrasja, sipas njoftimit të këtij institucioni, ndodhi në gusht të vitit 2019 dhe i pandehuri goditi viktimën me 14 plumba.

Kryetarja e trupit gjykues, Raima Elezi, njoftoi se palët kanë të drejtë që brenda 15-ditësh, pas pranimit të aktgjykimit në formë të shkruar, të ankohen në Gjykatën e Apelit. Avokati i palës së dëmtuar, Arianit Koci, me anë të një postimi në rrjetin social “Facebook”, ka thënë se tash e tutje vrasjet e grave do të

dënohen maksimalisht. “Gjykata, ashtu si e kam propozuar në cilësinë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, e ka dërguar porosinë në shoqërinë tonë: tash e tutje, vrasjet e grave do të dënohen maksimalisht. Përndryshe, ky vendim i guximshëm po e kthen besimin në sistemin e drejtësisë”, ka shkruar Koci.

Sipas aktakuzës, B. V. akuzohet se më 6 gusht 2019, në lagjen “Jeta e Re” në Prizren, me dashje ka privuar nga jeta bashkëshorten A. A.

Në aktakuzë thuhet se, pas një mosmarrëveshje paraprake me viktimën, në momentin kur

viktima po largohej nga shtëpia e tyre, i pandehuri u pajis me një pistoletë dhe shtiu drejt bashkëshortes 15 herë, duke e goditur 14 herë në pjesë të ndryshme të trupit.

Për veprën penale vrasje, sipas ligjeve në fuqi, një person në Kosovë mund të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim deri me burgim të përjetshëm.

Shoqëria civile ka kërkuar që vrasja e grave të trajtohet si urgjencë kombëtare nga sistemi i drejtësisë. Deri në qershor të vitit 2021, sipas Policisë së Kosovës, u shënuan dy raste të vrasjes së grave, ndërsa në vitin 2020 ishin vrarë shtatë gra.

## Edhe dy të vdekur nga Covidi në Kosovë

**PRISHTINË, 1 TETOR (ER)** - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të premtën janë regjistruar edhe dy viktima nga Covid-19. Sipas MSh-së, në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 42 persona të infektuar me këtë virus, pas testimit të 3 472 mostrave. Këto shifra nënkuptojnë se 1,2 për qind e personave të testuar kanë rezultuar pozitivë. Sipas autoriteteve shëndetësore, 409 persona janë shëruar derisa mbi 2 559 persona janë ende aktivë me koronavirus. Prej

shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 160 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 955 persona kanë vdekur. Prej nisjes së fushatës së vaksinimit 541 431 persona janë vaksinuar plotësisht kundër këtij virusi derisa 802 225 persona kanë marrë dozën e parë. Deri më 1 tetor në orën 15:00 është vaksinuar plotësisht 30.1 për qind e popullsisë së përgjithshme.



## Bordi i AGK-së diskuton për planet dhe projektet për tremujorin e fundit të këtij viti

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Bordi i Asociacionit i Gazetarëve të Kosovës (AGK) të premten ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën kryetari i bordit, Xhemajl Rexha, i ka njoftuar anëtarët për takimet e

zhvilluara me ambasadorë të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, për memorandumet e nënshkruara me Kolegjin AAB dhe forumZFD. Në takim u diskutua për aktivitetet që parashihen të zbatohen në

muajt në vazhdim, si dhe u ngrje nevoja që gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët të kenë një akreditim të vetëm institucional për t'i kryer më lehtë detyrat e tyre.



## Fillon puna për ndryshimin e pakos ligjore në sistemin prokuroria

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Në Ministrinë e Drejtësisë të premten u mbajt takimi i parë i grupit punues për ligjet e sistemit prokurorial në të cilin ka marrë pjesë ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, zëvendësministria Nita Shala, përfaqësues të institucioneve relevante, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Temë diskutimi gjatë këtij takimi ka qenë plotësim-ndryshimi dhe finalizimi i ligjeve për Këshillin Prokurorial të Kosovës, atë për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit. Ministria Haxhiu në fjalën e saj para të pranishmëve theksoi se reforma në drejtësi ka qenë dhe mbetet prioritet i saj. Ndër aktivitetet e kësaj ministrie,

Haxhiu ka theksuar rolin e Strategjisë për sundimin e ligjit. "Ndër obligimet dhe rekomandimet të cilat dalin nga Strategjia, janë edhe reformat brenda sistemit prokurorial. Kriteret për të qenë anëtarë të Këshillit Prokurorial, përbërja e Këshillit Prokurorial, përfshirë heqjen e kryeprokurorit nga Këshilli Prokurorial, rekrutimin dhe emërimin e prokurorëve bazuar në

parimet e objektivitetit dhe konkurrencës si dhe rekomandime të tjera të cilat duhet të trajtohen nga ky grup punues", ka thënë Haxhiu. Për ministrin Haxhiu, mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë, mungesë të llogaridhënies, ndikim politik dhe mungesë të rezultateve kualitative, mbetet shqetësuese dhe kjo duhet të ndryshojë. Ajo ka theksuar se ministria që drejton është e përkushtuar që të krijojë

kushte dhe politika sa më të mira për organet e drejtësisë. Ministria Haxhiu ka shprehur besimin e plotë që ka te ky grup punues për adresimin rekomandimeve të cilat dalin nga rishikimi funksional dhe çështje të tjera me rëndësi, me qëllim që të garantohet një Këshill Prokurorial në shërbim të sistemit dhe drejtësisë dhe prokurorë dhe prokurori në shërbim të qytetarëve.



## Në Podujevë paraqitet një rast i gripit të shpezëve 'Avian Influnza'

Podujevë, 1 tetor (ER) - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka njoftuar se është paraqitur një rast i gripit të shpezëve 'Avian Influnza' në fshatin Sekiraqë të komunës së Podujevës. "Është paraqitur një rast i gripit të shpezëve 'Avian Influnza' në

komunën e Podujevës në fshatin Sekiraqë. Nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë janë ndërmarrë të gjitha veprimet për parandalim të përhapjes së sëmundjes, ku përfshihet edhe asgjësimi i shpezëve në fermën e prekur. Po ashtu, janë duke u

kryer të gjitha hulumtimet epidemiologjike në fermat në zonën e prekur në perimetër prej tri kilometrash. Jemi duke i kryer të gjitha veprimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi", ka njoftuar Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

## KDI-ja: Komuna e Rahovecit, e para për transparencë komunale

RAHOVEC, 1 TETOR (ER) - Në raportin e publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), për vlerësimin e bërë sipas Transparometrit Komunal, për

nivelin e transparencës së 38 komunave të Republikës së Kosovës për periudhën janar-qershor 2021, komuna e Rahovecit është renditur në

vendin e parë me 83 pikë apo 94.32 për qind. "Komuna e Rahovecit gjatë periudhës vlerësuese (janar-qershor 2021) ka përbushur plotësisht 41

nga 44 indikatorët e Transparometrit, duke u renditur në mesin e komunave më transparente", thuhet në njoftimin e KDI-së.



## FSK-së i shtohen edhe 20 kadetë të rinj

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 TETOR - Ceremonia e betimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare e FSK-së u mbajt të premten në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Në prani të ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministrit të Mbrojtjes, Shemsi Syla, zëvendëskomandantit të FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, drejtorit të NALT-it, gjeneralbrigade Jorg Ruter, zyrtarëve të tjerë të lartë vendorë e ndërkombëtarë si dhe familjarëve, 20 të rinj dhe të reja

solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së dhe nënshkruan kontratat për shërbim në FSK. Pas intonimit të himnit shtetëror, me fjalë rasti u adresuan ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi si dhe komandanti i QSU-së, major Ali Haxhimustafa. Me këtë rast, para të pranishmëve ministri Mehaj ka theksuar se në fokusin e tij mbetet avancimi i sistemit të arsimit dhe stërvitjes në FSK. "Kjo do të realizohet me koncepte të përputhshme me bazën



doktrinale bashkëkohore të vendeve partnere dhe standardeve të NATO-s të cilat janë bashkë me ne pandërprerë për ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së. Sikur edhe më parë, edhe sot QSU me kadetët e saj është imazhi më i bukur dhe më i dashuri i gjithë Kosovës", ka thënë ministri Mehaj. Duke iu drejtuar kadetëve të rinj, Mehaj i porositi ata t'u përkushtohen studimeve që pastaj si oficerë të drejtojnë e komandojnë me kompetencë vartësit e tyre, për të përmbushur misionin kushtetues dhe detyrat ligjore në shërbim të vendit dhe qytetarëve të saj, pa dallim të përkatësisë etnike, fetare e racore. Ndërsa zëvendëskomandanti i

FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, ka theksuar se Qendra për Studime Universitare tashmë ka krijuar traditë në edukimin e oficerëve si një vatrë e dijes dhe e shkencës ushtarake. "Djemtë dhe vajzat e diplomuara në këtë qendër janë duke dhënë kontribute të jashtëzakonshme në Forcë, por edhe po përfaqësojnë në nivel të lartë FSK-në në të gjitha shkollimet dhe stërvitjet bashkë me aleatët tanë", ka deklaruar gjeneralmajor Cikaqi. Qendra për Studime Universitare e FSK-së funksionon që nga viti 2005 dhe nga kjo qendër deri më tani kanë dalë mbi 100 oficerë të FSK-së të cilët shërbejnë në nivele dhe njësi të ndryshme komando-shtabore të FSK-së.

## 24-vjetori i protestës studentore i '97-s nuk i bëri bashkë ish-liderët studentorë

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - 24-vjetori i protestës studentore i 1 tetorit të vitit 1997 nuk i ka bërë bashkë ish-liderët e kësaj proteste: Bujar Dugollin, Muhamet Mavrajn, Driton Lajçin dhe Albin Kurtin. Ky i fundit të premten me profesorin Ahmet Geca, si dhe disa nga pjesëmarrësit e tjerë të kësaj proteste, ministrin Xhelal Sveçla, zëvendësministrin Hysen Durmishi, Bujar Dugollin, Fatban Bunjakun, Jeton Rexhën, Lulëzon Jagxhiun, Mentor Bogajin, Milot Cakajn, Mihane Salihun dhe Veton Demajn, kanë nderuar ish-rektorin e Universitetit të Prishtinës, profesorin Ejup Statovci, drejtues i universitetit të vetorganizuar shqiptar dhe intelektual që priu në protestat e '97-s. "Çdo 1 tetor kujtojmë marshimin në protestat e '97-s të mijëra studentëve të veshur në të bardha, që me vullnet për liri e dëshirë për dije kërkonin

lirimin e ndërtesave dhe hapësirës universitare nga regjimi i atëhershëm serb dhe përkujtojmë intelektualin që na priu profesor Ejup Statovci", ka thënë kryeministri Kurti. Ai ka thënë se më 1 tetor të vitit 1997 u thye një heshtje dhe frikë e gjatë dhe popullit nisi t'i rikthehej dinjiteti. Pas kësaj, kryeministri Kurti ka pritur në zyrën e vet në qeveri disa nga bashkorganizatorët e protestës që bëri kthesë politike në Kosovë dhe bëri jehonë të madhe ndërkombëtare. Në takim ishin edhe familjarë të profesorit të ndjerë Ejup Statovci, profesoresha Drita Halimi-Statovci dhe Anila Statovci. Muhamet Mavraj, një ndër organizatorët e protestës të 1 tetorit të vitit 1997, ka deklaruar se ka pasur ftesë nga kryeministri Albin Kurti që të marrë pjesë në homazhe te varri i profesorit Ejup Statovci,



po ashtu edhe në takim me organizatorët të tjerë, por ky nuk ka pranuar të shkojë. Mavraj për "Klan Kosova" ka

thënë se e ka parim që kur i ka shokët në pushtet nuk u shkon dhe nuk u përgjigjet ftesave të tyre. As Driton Lajçi nuk i është

përgjigjur ftesës së kryeministrit Kurti për 24-vjetorin e protestës të 1 tetorit të vitit 1997.

## Kosova dhe Sllovenia, mundësi të reja bashkëpunimi në bujqësi

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka pritur të premten në një takim ambasadorën e Sllovenisë në Kosovë, Minca Benedejcic, të shoqëruar nga drejtori i Odës Slovene të Bizneseve, Bajram Fusha, me të cilët ka diskutuar rreth mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm në sektorët që mbuloohen nga MBPZh-ja, me qëllim të fuqizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë në gjithë vendin. Gjatë këtij takimi ministri Faton Peci ka paraqitur prioritetet dhe projektet zhvillimore të cilat planifikohen të realizohen gjatë këtij mandati e të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë së këtij sektori, i cili është kontribuuesi kryesor për zhvillim ekonomik. "Ekspertiza slovene është e mirëseardhur qoftë për shkëmbimin e përvojave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve ashtu edhe për arritjen e kritereve të IPARD në mënyrë që

Kosova të ketë qasje direkte në fondet e Bashkimit Evropian për avancim të sektorit të bujqësisë", ka thënë Peci.

Duke e falënderuar shtetin sloven për mbështetjen e vazhdueshme që e ka dhënë për Kosovën, ministri Peci ka theksuar se të dy vendet kanë shumë mundësi bashkëpunimi në fushën e ekonomisë dhe bujqësisë në veçanti.

Në këtë takim ata u pajtuan që të krijojnë partneritete të reja mes të dyja shteteve, me qëllim të krijimit të mundësive për bashkëpunim mes afaristëve nga Kosova dhe atyre nga Sllovenia duke nënshkruar një memorandum bashkëpunimi mes dy shteteve në të ardhmen me qëllim të avancimit të sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë.

Në anën tjetër, ambasadorja e Sllovenisë në Kosovë, Minca Benedejcic, shprehu gatishmërinë e saj për ta thelluar edhe më tej partneritetin mes MBPZhR-së dhe Ambasadës së Sllovenisë në Kosovë dhe rikonfirmoi gatishmërinë e shtetit të saj për ta ndihmuar zhvillimin bujqësor të Kosovës.



## Qeveria dhe MCC nënshkruajnë "Memorandum ndihme" për zhvillimin e programit të kompaktit



**PRISHTINË, 1 TETOR (ER)** - Kryeministri Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, kanë zhvilluar diskutime me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), drejtoreshën menaxhuese për Evropë, Azi, Shtetet Pacifike dhe Amerikën Latine, Caroline Nguyen, dhe drejtoreshën për Kosovë, Sarah Olmstead, rreth dizajnit të programit të kompaktit. Duke pasur parasysh afatin kohor strikt për të zhvilluar dhe nënshkruar programin e kompaktit, dhe që Qeveria e Kosovës kërkon informata të mëtejshme për të qenë në gjendje të marrë vendim të mirinformuar për ta ndërtuar infrastrukturën e gazit, Qeveria e

Kosovës ka vendosur ta përdorë programin kompakt për investime në projekte që kanë më shumë siguri por që, gjithashtu, kontribuojnë në mënyrë domethënëse drejt tranzicionit energjetik të Kosovës. Pas diskutimeve, qeveria e Kosovës dhe ekipi i MCC-së kanë nënshkruar një Aide Memoire (Memorandum ndihme) për ta hapur rrugën drejt implementimit të programit dhe partneritetit për ndërtimin e një të ardhme më të mirë për qytetarët e Kosovës. Së bashku, MCC-ja dhe Qeveria e Kosovës janë duke punuar drejt një peizazhi energjetik që mundëson zhvillimin e bizneseve dhe një tranzicion të drejtë energjetik për Kosovën.

## Fillon subvencionimi i kredive konsumuese

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka bërë me dije se të premten kanë operacionalizuar edhe masën 3.6 për mbështetjen e likuiditetit familjar që nënkupton subvencionimin e kredive konsumuese. Ai ka treguar se kush mund të përfitojë nga subvencionimi i kredive konsumuese. "Të gjithë personat që marrin kredi konsumuese deri në shumën 10 000 euro, nga data 1 tetor 2021 e tutje, do të mund të aplikojnë për subvencionim të kredisë", ka thënë Murati, duke treguar edhe shumën e subvencionimit. "Shuma

që përfiton secili aplikues që kualifikohet është 10 për qind e shumës së kredisë, deri në maksimumin prej 300 eurosh. Shembull: Nëse kredia është 1 500 euro, subvencionimi do të jetë 150 euro; Nëse kredia është 3 000 euro, subvencionimi do të jetë 300 euro; Nëse kredia është 5 000 euro, subvencionimi do të jetë 300 euro", ka deklaruar ai, duke theksuar se pasi të keni marrë kredinë nga një institucion financiar i licencuar, duhet ta plotësoni formularin për aplikim (i cili do të publikohet ditët në vijim). "Pas konfirmimit të saktësisë së aplikacionit, subvencionimi paguhet në llogarinë bankare të kredimarrësit", ka treguar ministri Murati.





# Sun Tzu vs Carl Von Clausewitz: Kush ishte strategu më i madh i të gjitha kohërave?



Në historinë e strategjisë ushtarake, asnjë teoricien nuk ka fituar të njëjtin respekt apo të ketë pasur aq shumë ndikim sa Sun Tzu dhe Carl von Clausewitz brenda traditave të tyre përkatëse. Sun Tzu ishte një gjeneral kinez dhe strateg i lashtë ushtarak që jetoi në shekullin V Para Krishtit dhe autor i mirënjohur i librit "Bingfa" (Arti i Luftës), vepra më e hershme e njohur mbi strategjinë ushtarake. Ndërkohë Carl von Clausewitz ishte një gjeneral dhe strateg prusian në fundin e shekullit XVIII dhe fillimin e shekullit XIX, që u angazhua në Luftërat Napoleonike. Ai është i famshëm për veprën e tij "Vom Kriege" (Mbi luftën) e botuar në vitin 1832.

## Çfarë ishte lufta për Sun Tzu dhe Clausewitz?

Dallimi i parë domethënës midis Sun Tzu dhe Clausewitz ka të bëjë me kuadrin e analizës së tyre. Kuadri i Sun Tzu përbëhet nga një perspektivë e gjerë mbi luftën, e cila përfshinte jo vetëm çështjet ushtarake, por edhe një larmi të madhe faktorësh jo-ushtarakë që megjithatë ndikojnë në fushën ushtarake, të tilla si diplomacia, ekonomia dhe psikologjia. Ndërkohë ai i Clausewitz është shumë më i ngushtë, dhe i përbërë ekskluzivisht nga çështjet ushtarake. Ai e njehtë rëndësinë e fushave të tjera, dhe faktin që lufta nuk është asnjëherë një akt i izoluar. Në fakt Clausewitz është i famshëm për aforizmin e tij se "Lufta është vazhdim i politikës

me mjete të tjera".

Por këta faktorë nuk kanë shumë rëndësi në detyrën e një gjenerali. Clausewitz e përkufizon luftën si "një akt dhune që synon ta detyrojë kundërshtarit të përbushë vullnetin tonë". Fitorja është objekti, dhe dhuna është mjeti. Faktorë të tjerë kanë rëndësi vetëm për aq sa ndikojnë në aftësinë e një gjenerali për të fituar luftën.

Lufta kërkon agresion. Pozicioni mbrojtës është më i forti, por ai kërkon një mbrojtje absolute që e kundërshton idenë e luftës. Ofensiva është e nevojshme për të fituar luftën dhe për të arritur një objektiv pozitiv. Clausewitz favorizon një qasje të guximshme të rrezikut të balancuar me llogaritjet racionale. Një gjeneral i madh është ai që zbaton me sukses një strategji maksimale, në të cilën arrihet rezultati më i mirë.

## Paqja vs lufta

Për shkak të këndvështrimeve të ndryshme, Sun Tzu dhe Clausewitz nxorën përfundime të ndryshme në lidhje me natyrën e paqes dhe konfliktit në vetvete. Ndërsa luftimet ushtarake nuk ekzistojnë gjithmonë, konflikti është i përhershëm në arenat e tjera, të tilla si politika, ekonomia dhe shoqëria në përgjithësi. Në këtë kuptim, lufta është e vazhdueshme.

Për shkakun e këtij përfundimi, ka shumë kuptim që Sun Tzu i dha përparësi një strategjie maksimale, në të cilën një gjeneral është i matur në përdorimin e burimeve

të tij. Në një konflikt të vazhdueshëm, minimizimi i humbjeve të dikujt, mund të bëjë të diferencën midis kapitullimit të hershëm dhe mbijetesës në "lojën e gjatë".

Ndërkohë përkufizimi më i ngushtë i luftës nga Clausewitz, i dha atij mundësinë të bënte një dallim shumë të qartë midis gjendjeve të luftës dhe paqes. Sipas tij, konflikti ekziston vetëm kur ushtria është e angazhuar. Prandaj, fitimi i një lufte është mënyra më e shpejtë dhe më efektive për ta kthyer shoqërinë në një gjendje paqeje.

Dallimet midis koncepteve të Sun Tzu dhe Clausewitz mbi paqen dhe luftën, mund të jenë edhe pasqyrim i kohëve në të cilat ata jetuan. Sun Tzu shkroi gjatë Periudhës Kaotike të Shteteve ndërluftuese në Kinë, kur lufta e vazhdueshme dhe e përshkallëzuar mund të shkatërronte lehtësisht një shtet që nuk ishte i kujdesshëm në ruajtjen e burimeve.

Ndërkaq, Clausewitz shkroi gjatë shekullit XX-të, një periudhë transitore drejt luftës moderne me ndërprerje por në shkallë të gjerë, e zhvilluar midis kombeve të fuqishme dhe në një botë gjithnjë e më të globalizuar.

## Ekonomia e forcës

Për Sun Tzu, forca duhet të përdoret me masë, dhe tek ajo duhet mbështetur vetëm pasi të jenë shterur të gjitha opsionet e tjera. Në vend se të mbështetet tek forca brutale, forca e ushtrisë

duhet të plotësohet me shumëzues të forcës si terreni, surpriza dhe faktorë të tjerë që ofrojnë një avantazh krahasues. Sipas strategut kinez, efektiviteti nuk është më i rëndësishëm se efikasiteti, sepse një shtet që fiton një luftë, por del i dobësuar në mënyrë të pariparueshme, nuk mund ta gëzojë fitoren e tij për një kohë të gjatë. Në këtë kuptim, teoria e Sun Tzu përqendrohet në shmangien e forcës së përdorur me nxitim.

Ai i inkurajon gjeneralët që të përdorin strategji dhe taktika, për të krijuar kushtet ideale për përdorimin efektiv të forcës. "Arti i luftës" flet gjerësisht për rëndësinë e dijes, mashtrimin.

Një komandanti ideal mbledh informacionet inteligjente mbi armikun e tij, dhe sulmon vetëm kur ka avantazhe dhe kur fitorja është e siguruar.

Ndërkohë, Clausewitz e konsideron forcën jo vetëm të nevojshme, por edhe si strategjinë më efektive. Sipas tij duhet të përdoret sa më shpejt që të jetë e mundur forca maksimale për t'i dhënë fund luftës në afatin më të shkurtër të mundshëm. Clausewitz është i orientuar drejt rezultateve.

Sipas tij efektiviteti është më i rëndësishëm sesa efikasiteti, dhe burimet e humbura në një betejë të madhe mund të rikuperohen nëse beteja sjell një fitore vendimtare që i jep fund luftës. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se Clausewitz ishte i verbër ndaj faktit se burimet njerëzore janë të vështira të zëvendësohen pasi i ke

humbur.

Për të arritur fitoren në mënyrën më të mirë, duhet që forca të ushtrohet me guxim dhe strategji. Një komandanti ideal mund t'i balancojë që të dyja këto. Ai është i aftë dhe vendimtar, një gjeni strategjik dhe taktik, dhe ka një fuqi të madhe të mendjes, imagjinatës dhe forcës së vullnetit.

## Cila është fitorja ideale

Për Sun Tzu, fitorja më e madhe është ajo e arritur pa luftë. Pra të arrish të bindësh ushtrinë armike të dorëzohet para se të fillojë beteja. Por që të ndodhë kjo, zbatimi i strategjisë së preferuar nga Sun Tzu përfshin mjete jo-ushtarake dhe ruajtjen e forcës ushtarake deri në momentin e duhur.

Ndërkaq fitorja ideale e Clausewitz është asgjësimi i plotë i ushtrisë së armikut në një betejë të madhe vendimtare. Mjeti kryesor për zbatimin e strategjisë së tij është ai i forcës. Në dispozicion janë edhe mjete të tjera, por ato nuk konsiderohen parësore.

Sidoqoftë, thjeshtësia në dukje e formulës së Clausewitz, nuk duhet të ngatërrohet me mungesën e sofistikimit. Ai shkroi: "Në luftë çdo gjë është shumë e thjeshtë, por gjëja më e thjeshtë është në fakt më e vështira". Sipas tij gjeneralët duhet të jenë në gjendje të kapërcejnë çdo lloj rrethanash dhe vështirësish të paparashikuara.

Marrë me shkurtime nga The Collector - Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Challandesi dhe Neesi publikojnë listat e futbollistëve

Përfaqësueset e Kosova A dhe U21 do t'i zhvillojnë ndeshjet e radhës kualifikuese në këtë muaj, derisa të premten përzgjedhësit Bernard Challandes dhe Michael Nees kanë publikuar listat e futbollistëve. "Dardanët" stërvitjen e parë e zhvillojnë të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri", kurse "dardanët" e rinj po të njëjtën ditë zhvillojnë stërvitjen e parë në kompleksin e FFK-së në Hajvali

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Dy përzgjedhësit e përfaqësuesve të Kosovës, Bernard Challandes (Përfaqësuesja A) dhe Michael Nees (Përfaqësuesja U21), në ditën e parë të muajit tetor kanë publikuar listat e futbollistëve për ndeshjet e muajit tetor. "Dardanët" në këtë muaj do të zhvillojnë dy ndeshje kualifikuese për Botërorin "Katari 2022", fillimisht do të luajnë si mysafirë të Suedisë në Solna, më 9 tetor, ndërsa ndeshjen e dytë e zhvillojnë më 12 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë kundër Gjeorgjisë. Federata e Futbollit të Kosovës ka njoftuar se përzgjedhësi

Challandes e ka ftuar edhe futbollistin e Vitesses, Toni Domgjoni, por ai është ende në pritje të lejes nga FIFA. "Pjesë e listës është edhe futbollisti i Vitesses, Toni Domgjoni, por i cili ende është në pritje për të marrë lejen nga FIFA për t'u paraqitur në fanellën e Kosovës", thuhet në njoftimin e FFK-së. "Dardanët" fillojnë grumbullimin në hotel "Emerald" pas ndeshjeve të fundjavës me klubet e tyre, ndërsa stërvitjen e parë e zhvillojnë të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 19:00. Përzgjedhësi zviceran i Kosovës të hënën në orën 11:00 mban konferencë për media. Kosova është pjesë e grupit B, ndërsa pas pesë ndeshjeve ka grumbulluar 4 pikë dhe renditet në vendin e



katërt. Listën e futbollistëve të premten e bëri publike edhe përzgjedhësi i "dardanëve" të rinj, Michael Nees. Kosova U21 në këtë muaj zhvillon dy ndeshje kualifikuese kundër Republikës së Çekisë. Ndeshja e parë zhvillohet më 7 tetor në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 19:00, ndërsa ndeshja e dytë më 12 tetor në Ceske Budojevice në orën 18:00.

"Dardanët" e rinj grumbullohen të hënën në hotel "Sheraton", derisa stërvitjen e parë do ta zhvillojnë në orën 15:00 në kompleksin e FFK-së në Hajvali. Kosova U21 bën pjesë në Grupin G të kualifikimeve të Evropianit 2023, ndërsa pas dy ndeshjeve të zhvilluara ka një fitore (me Andorrën) dhe një humbje (me Anglinë).

### Përfaqësuesja A

Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Samir Ujkani, Mërgim Vojvoda, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Florent Hadergjonaj, Betim Fazlij, Mirlind Kryeziu, David Domgjoni, Lirim Kastrati, Ibrahim Dresheviq, Besar Halimi, Herolind Shala, Florian Loshaj, Florent Muslija, Toni Domgjoni, Lirim Kastrati, Bersant Celina, Zymer Bytyqi, Elbasan Rashani, Milot Rashica, Astrit Selmani, Vedat Muriqi.

### Përfaqësuesja U21

David Ndreca, Leo Beson, Flamur Gashi, Petrit Terziu, Andi Hoti, Leard Sadiu, Edvin Kurtulus, Valon Zumberi, Florian Hoxha, Leonat Vitija, Bujar Pllana, Erion Sadiku, Kreshnik Krasniqi, Florent Hoti, Adrijon Pajaziti, Altin Kryeziu, Ismet Lushaku, Gentrit Limani, Diamant Berisha, Valmir Veliu, Dion Berisha, Altin Zeqiri, Ardit Tahiri, Mark Marleku.

## Sot përballen dy skuadrat e para në tabelë, nesër Drita - Prishtina



**PRISHTINË, 1 TETOR (ER)** - Java e tetë në BKT Superligën e Kosovës në futboll do të sjellë ndeshje interesante. Sot (e shtunë) në Suharekë përballen dy skuadrat e para në tabelë, Drenica dhe Ballkani. Vendasit janë pa fitore në dy ndeshjet e fundit dhe synim e kanë që të mposhtin skuadrën kuqezi dhe ta marrin primatin në elitë, në anën tjetër Drenica pret rezultat pozitiv edhe nga kjo ndeshje në mënyrë që ta ruajë formën e mirë që ka treguar në

këtë kampionat. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Malishevës dhe Gjilanit. Të dyja këto skuadra luajnë për fitore në këtë ndeshje. Të dielën zhvillohen tri ndeshjet e tjera, kurse vëmendja kryesore do të jetë në Gjilan mes nënkampiones, Dritës dhe kampiones në fuqi, Prishtinës. Në mesjavë të dyja këto skuadra nuk arritën rezultate të mira dhe në këtë ndeshje kërkojnë maksimumin. Llapi që po kalon nëpër një krizë të madhe

### Superliga - Java 8

**Të shtunën takohen:**  
15:00 Ballkani - Drenica  
15:00 Malisheva - Gjilani

**Të dielën takohen:**  
15:00 Drita - Prishtina  
15:00 Llapi - Dukagjini  
15:00 Feronikeli - Ulpiana

rezultatash do të përballen me Dukagjinin e Klinës, kurse Feronikeli ka punë me Ulpianën.

## Liga Unike e Femrave, garë që po pritet me interesim të madh

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Liga Unike edicionin e kaluar u zhvillua në formë të Final 8 për shkak të pandemisë Covid-19. Por, edicioni i ri pritet të jetë shumë interesant, ndërsa risi do të jetë Liga Unike në konkurrencën e femrave. Në konkurrencën e femrave nga Kosova do të marrin pjesë: Penza, Bashkimi dhe Prishtina, ndërsa nga Shqipëria: Flamurtari, Partizani

dhe Tirana. Në edicionin e kaluar në Kosovë titullin e fitoi Penza, Kupën e fitoi Prishtina, kurse Superkupën, skuadra e Bashkimit, duke bërë që të tre trofetë të shkojnë në skuadra të ndryshme. Në Shqipëri në vitet e fundit ka pasur një rivalitet të madh për titull, ndërsa së fundi u organizua Kupa e Federatës së Shqipërisë, ku Flamurtari në

finale mundi Partizanin me rezultat 83:65. Në konkurrencën e femrave Liga Unike do të zhvillohet me sistem vajtje-ardhje në edicionin 2021-2022. Pas përfundimit të 10 xhirove të rregullta në konkurrencën e femrave, vendet 1-4 kualifikohen për Final 4, respektivisht vendet 1-4 dhe 2-3 luftojnë për vendin e tyre në finale përmes ndeshjeve me sistem eliminimi.



## Australian Open mund të zhvendoset në Dubai

MELBURN, 1 TETOR - Për momentin duket vetëm si një ide, si një hipotezë, por ditët e fundit janë shtuar zërat se grand slam i Australian Open, turneu i parë i madh i vitit 2022 në tenis, të zhvillohet në një shtet tjetër dhe jo në Australi. Gjithçka mund të ndodhë për shkak të masave të rrepta anti-Covid që ekzistojnë në Melburn, që u aplikuan edhe këtë vit, por që sollën mjaft

pakënaqësi te tenistët. Ideja është që ky turne të zhvillohet në Dubai, por për momentin nuk ka asgjë konkrete, pasi organizatorët shpresojnë që situata deri në janar të jetë më e mirë. Përvoja e vjetshme ishte një makth për tenistët, që qëndruan dy javë në karantinë pas mbërritjes në Melburn. Më pas ata qëndronin të izoluar dhe dilnin nga hoteli vetëm për stërvitje

dhe ndeshje. Ndaj tenistët nuk duan ta përjetojnë sërish këtë situatë, ndërkohë që në turnetë e tjerë ka pasur më shumë lirshmëri. Në Dubai janë gati t'i mirëpresin kualifikueset e meshkujve të Australian Open ashtu sikurse edhe këtë vit. Por ata synojnë të organizojnë të gjithë turneun, pasi aty zhvillojnë fazën përgatitore gjatë dimrit shumica e tenistëve.



## Ylli - Prishtina, sfida e së vërtetës

PRISHTINË, 1 TETOR - Pas takimit Trepça - Peja që përfundoi 83:66, java e katërt e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll, do të vazhdojë në fundjavë me ndeshje shumë interesante. Rahoveci dhe Bashkimi, që nuk e kanë nisur aq mbarë edicionin e ri me një fitore dhe dy humbje, do të përballen të shtunën, një takim që pritet të jetë i barabartë, duke marrë parasysh formën e këtyre dy skuadrave në edicionin e ri. Ndërkohë, Prizreni 16, që e fitoi Superkupën dhe në Superligë ka dy fitore dhe një humbje, do të përballlet me RC Cola Dritën. Prizrenasit shihen favoritë,



ndërsa gjilanasit kanë tri humbje në tri ndeshje, duke mos arritur të shënojnë fitore në elitë. Takimi i fundit, por më interesanti, shihet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Sigal Prishtinës. Therandasit, edhe pse kanë bërë shumë përforsime, edicionin e ri në elitë e kanë nisur me tri humbje në tri ndeshje, ndërsa prishtinasit kanë një skuadër në ndërtim e sipër dhe kjo

do të jetë një sfidë e vërtetë për basketbollistët e rinj prishtinas. Bardhekaltrit kanë dy fitore dhe një humbje. Në bazë të vendimit të fundit të Qeverisë së Kosovës, lejohen 10 % e shikuesve në palestrat ku zhvillohen ndeshjet e basketbollit, duke pasur certifikatën e vaksinimit, ose një nga tri dëshmitë alternative, testin PCR, serologjik ose testin rapid.

### Superliga - Java 4

Trepça - Peja 83:66

Të shtunën takohen:

17:15 Rahoveci - Bashkimi  
19:00 Prizreni 16 - RC Cola Drita

Të dielën takohen:

17:15 Golden Eagle Ylli - Sigal Prishtina

## Tare: Mourinho dhe Roma duhet të mësohen ta pranojnë humbjen

ROMË, 1 TETOR - Drejtori sportiv i Lazios, shqiptari Igli Tare, i kërkoi Romës që ta lërë pas humbjen e derbit pas komenteve të trajnerit Jose Mourinho dhe drejtorit Tiago Pintos. Lazio fitoi 3-2 në përballjen derbi të së dielës në Serinë A, por Mourinho përsëri iu referua asaj loje pas një fitore 3-0 të Ligës së Evropës në udhëtim të Zorya. Trajneri këmbënguli se ata kishin "dominuar" në derbin kryeqytetas dhe e cilësoi Lazion si skuadër e vogël. "Nuk më pëlqen ajo që bëri Roma pas përfundimit të ndeshjes. Ishte befasi t'i shihja ata ende duke folur për gabimet e gjyqtarëve katër ditë më vonë kur, nëse kishte ndonjë gabim, ata ishin të dëmshëm për Lazion", ka thënë Tare për "Sky Sport Italia". "Duhet të mësohen të pranosh humbjen dhe të nxjerrësh më të mirën nga vetja, gjë që bëri Roma të enjten. E tëra



çfarë ju duhet të bëni është ta analizoni atë rast pas rasti për të parë që nuk ka pasur gabime nga gjyqtarët kundër Romës. Nëse ka ndonjë gjë, ata ishin kundër Lazios. Kishte një penallti që nuk na ishte

dhënë, nuk kishte asnjë arsye për të kërkuar që Lucas Leiva të përjashtohet, dhe penalltia ndaj Nicolò Zaniolos u pa vetëm nga Irrati në dhomën e VAR-it", ka shtuar Tare.

### SHKURT

#### Abrashi humbet dy ndeshjet kualifikuese për Botërorin 2022

Amir Abrashi dëmtohet sërish dhe nuk mund të jetë me Shqipërinë në dy ndeshjet më të rëndësishme të kualifikueseve të Botërorit "Katar 2022". Mesfushori, i cili mban edhe shiritin e kapitenit të Grasshoppers, është dëmtuar pasi u rikthye dhe tani i duhet të qëndrojë gjashtë javë jashtë fushave të blerta. Trajneri Reja tashmë do të duhet t'i bëjë llogaritë pa një prej lojtarëve më të rëndësishëm në sfidat kundër Hungarisë dhe Polonisë që janë në program të luhen më 9 dhe 12 tetor.

#### Koemani pritet të shkarkohet pas ndeshjes ndaj Atleticos

Skuadra e Barcelonës pritet të bëjë ndryshime në stafin teknik. Kjo skuadër nuk e ka nisur aspak mirë këtë edicion sidomos në Ligën e Kampionëve ku ndodhet në pozitën e fundit në grup pas dy ndeshjeve të para. Kjo ka bërë që drejtuesve të klubit t'u humbet durimi për trajnerin Ronald Koeman. Sipas raportimeve të fundit nga mediat spanjolle, Koeman do të shkarkohet pas ndeshjes ndaj Atletico Madridit që luhet të shtunën. Presidenti i klubit, Joan Laporta, ka mbetur i befusuar nga holandezi pasi beson që ekipi i tyre mund të bëjë më shumë me një trajner tjetër në krye. Si emra të mundshëm për ta zëvendësuar Koeman në stolin e Barçës po përmenden Xavi, Roberto Martinez dhe Andrea Pirlo.

#### Ferinand: Bayerni është favoriti kryesor në Ligën e Kampionëve

Ish-mbrojtësi i Manchester Unitedit, Rio Ferdinand, ka thënë se Bayern Munchen është favoriti kryesor në Ligën e Kampionëve. Ish-mbrojtësi anglez e ka lavdëruar edhe trajnerin Julian Nagelsmann. "Ky FC Bayern është një favorit për Ligën e Kampionëve. Një skuadër fantastike me njëmbëdhjetëshe të pabesueshme dhe një stol të mirë. Julian Nagelsmann nuk është vetëm një teknik mjeshtër, por edhe një zhvillues. Shikoni Leroy Sane. Ai është si një lojtar i ri. Sipas mendimit tim, ai është anësori më i mirë në botë tani me Salah", ka thënë Ferdinand.

#### Mançini: Donnarumma është portieri më i mirë në botë

Portieri Gianluigi Donnarumma e nisi ndeshjen e fundit të Paris Saint-Germain kundër Manchester Cityt. Në shumicën e ndeshjeve të tjera Mauricio Pochettino po i beson vendin e titullarit Keylor Navas e në lidhje me këtë me folur edhe trajneri i "Azzurëve", Roberto Mançini. "Donnarumma luajti një lojë të mrekullueshme kundër Manchester City. Ai është portieri më i mirë në botë dhe edhe nëse PSG tashmë ka një portier tjetër të lartë, nuk mendoj se Donnarumma do të kalojë shumë kohë në stol", ka thënë Mançini. Italiani u transferua te PSG-ja në afatin kalimtar të verës si futbollist i lirë, ndërsa tani është ftuar nga Kombëtarja e Italisë për ndeshjen e Ligës së Kombeve.

## Kane: Të qëndrojmë së bashku si skuadër

Sulmuesi anglez Harry Kane ka insistuar se tani është koha për Tottenham Hotspur që të qëndrojë prapa trajnerit Nuno Espirito Santo dhe t'u rikthehet rezultateve pozitive në Premierë Ligë. Në

ndeshjen e Ligës së Konferencës, Kane u inkuadrui në pjesën e dytë kundër skuadrës së Muras, ku shënoi tre gola në fitoren 5-1. "Ne si lojtarë dhe staf duhet të qëndrojmë së bashku dhe të punojmë

shumë. Forma jonë momentale nuk është e mirë, por na duhet të rikthehemi më të mirë në ndeshjen e radhës. Çdo sulmues dëshiron që të shënojë gola. Të them të drejtën nuk e prisja inkuadrimin, por

është gjë e mirë të luash. Kudo që e shih topin, dhe ta godasësh direkt në portë, është një ndjenjë tejet e mirë. Shpresoj shumë që ta përsëritim këtë paraqitje edhe në fundjavë", ka thënë Kane.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1003/1

Dt: 01.10.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Nenin 8 të Ligjit të Punës nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ 07/2017 (MPMS), si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendit të lira në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, për vitin shkollor 2021/22

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Malishevë	Një (1) punëtor teknik	Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën punëtor teknik

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra tjera të cilat i ndan drejtori i shkollës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma mbi Shkollën e përfunduar,
- Të ketë etikë të lartë të punës.

Paga: koef 4

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 nga dita e shpalljes. Dokumentet e kërkuara të dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime, letërnjoftimi dhe dokumentet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen.

Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arbnora Muqaj shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Mjekësisë "Hysni Zajmi" ne Gjakovë.

▶ Brezjan Dakaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Nazim Kokollari Budakova " Prizren.

▶ Jetsin Kosova shpall te pavlefshme 3 dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

